LULET E VERËSË

NAIM FRASHËRI

JETA

Sa e dua gjithë jetën!
Se atje gjenj të vërtetën,
Yjtë, nënën, hapësirën,
Të mugëtit, natën, ditën,
Mëngjezë, djellinë, dritën,
Mbrëmën, dh'atë errësirën

Natën, kur ësht'e qetuar,
Edhe gjësendi s'dëgjonet;
Qjellin kur ësht'i qëruar,
E hapësira ndritonet,
Ret' e zeza sterrë nd'erë.

Vapën, vjeshtën, dimrin verën,
Retë, shinë, dhe lumenjtë,
Gjëmim, mjërgullë, përrenjtë,
Dborën, brëshërin'e erën,

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-

Malet, fushat edhe brigjet,
Grykat, çukat edhe shtigjet.

Oshëtimën, pyjet, drurët,
Shkëmbenjtë, gërxhet’e gurtë.
Lulet, barërat që mbijnë,
E shpesët që fluturojnë,
Edhe këngëra këndojnë,
E në për dega lëvrijnë.

Dhe njerin’e bagëtinë
Dhe gjithë ç’është në jetë
I dua si Perëndinë,
Se nga do që këthenj sytë
Shoh atje Zotn’e vërtetë
Q’është një e s’ka të dytë.

KOH’E SHKUARË

Kam pushuar, jam qetuar,
E rri më nj’an’e derth lot,
Me zemër të përvëluar,
Me hulm me hidhërim plot.

Si zogu, kur bje e fryn
Dheu mbushet me dëborë,
Nën’ strehët i mjeri hyn,
Rri i varfër e i gjorë.

Sheh dëborënë që bije,
Edhe zinë që ka rënë,
Botën pa shij’e pa hije,
Dhe s’guxon të nxier zënë.

S’sheh gjëkundi lul’e fletë
Po të ngrit’e ftohtësire,
Jetënë gjithë të qetë,
Gjithësinë shkretëtirë.

Dhenë të bardhë si vezë,
Dhe pa gjeth’e pa burbuqe,
Zëmrëzën’e tij të zezë,
Q’e pat si lule të kuqe.

Më s’sheh shok, as fis, as miq.
As fëmijë, as folezë,

Shpresëza e tij i vdiq,
E ju përhap posi rezë.

Pa kokëzën’e fut në gjit,
Mbyll syt e hyn në mejtim,
Mejtohet edhe psherëtit
Me mall shum’e mallëngjim.

Mos pandeh se fle, a dremit,
Kur e sheh q’është qetuar,
Dhe këllet kokëzën në gjit,
Është gjithënjë i xgjuar.

Me mëndjezët të tij thotë,
Ah! shkoj, vate, koh’ e mirë,
Dua e mundohem kotë,
S’e kthej dot me të pahirë.

ju drurët’e uruar!
Ju shoh pa lul’e pa fletë,
Të rjepur të varfëruar,
Edhe të that’e të shkretë!

Kështu si ju edhe unë
Ndë jetë të shkret u thashë,
O! sa fletë m’u-këpunë,
Edhe ran’e më s’ i pashë!

Edhe ju fusha e male
Që nukë prishi e s’ndrohi,
Edhe ju dale nga dale
Më duketë po ndryshojti!

Ah! dhe ju ishit të tjerë,
Yjt’ e bukur, e ti hënë
Kur u shikonja një herë
Tani një zi u ka rënë.

Moj kohëz’ e djalërisë
Sa me vrap ike dhe shkove,
Hyre në gjit të Perëndisë
Edhe mua më harove.

Ti çdo gjëzë m’a tregove
Të bukur e fort të mirë,
Edhe gazë m’a shumove

E m’epnje shumë dëshirë.

Si t’ja bënjë zemr’e mjerë,
Me kohën gënjeshtare
Që ndrohetë kurdoherë,
Dhe s’ngjan ime të parët fare!

Duke ikur na rrëmben,
Gjithë ç’duam e ç’gjë kemi,
Ah! e shkreta ç’na gënjen,
Ashtu si qemë më s’jemi!

Le të bëhet urdhëri yt,
Zot’ i math e i vërtetë!
Po pse të na mbetet në syt
Kjo koh’e shkuar e shkretë?

DIT’E RE

Sot është një dit’e rëzë që përsëritet moti,
Lint vera, lint ngrohtësija, lint Aliu vetë Zoti.
Është një dit’e bekuar, që rrjedh qiejshit bukurija,
Del në sheshi Zot’i vërtetë, rrëfen fytyrën e tija.

Ngjallen të vdekurit gjithë, mal’e fusha gjelbërojnë,

Qielli qesh, dheu gëzohet, dhe lulet lulëzojnë.

Thonë dimëri na prishi, po s’na humbi dot për jetë,

Erdhi kjo dit’e na gjeti, nuk’e la dhenë të shkretë.

Qielli ësht ndrituar edhe bërë si pasqyrë,

Dheu është zbukuruar, bërë fytyrë fytyrë.

Veshur në bar e në lule edhe në gjethe në fletë,

Bukuri e Perëndisë ka dal’e duket në jetë.

Ujërat po burojnë, dhe venë duke kënduar,

S’shoh gjësendi të pëlyrur, gjithë janë lar e ndruar.

Shqerratë po blegërijnë, edhe mëmate kërkojnë,

Zoqtë nër gjethe lëvrijnë, dhe këndojn’e fluturojnë.

Gjithë ç’janë ngjallen, çelen, përsëriten, zbukurohen,

Duhen, qeshin, rrojnë, prehen edhe këndojn’e gëzohen.

Lint Aliu, çfaqet dita, del Zoti, vjen e vërteta,

Mbleron dheut ëmbëlsira, edhe rojit po si bleta.

Në këtë gosti të Zotit gjithë bota janë ftuar,

Të bëhen një shpirt një trup e të jenë të pajtuar.

Është dit’e dashurisë, ditë e vëllazërisë,

Dit’e mbarë e gëzimit, dit’e bardhë e miqësisë.

njeri! paskëtaj kurrë fjalë të ligë mos thuash,

Po përshëndosh gjithë ç’janë, thuaj gëzuash! gëzuash!

PËR SE?

Pse s’vjen, o dit’e mirë,
Pse vallë nukë vjen?
Gjer kur në errësirë?
Mos Zoti të pëlqen?

As hidhe gardhe,
Dhe shpejto pakë,
dit’e bardhë,
Dhe jakë, jakë,

Se të pres,
Nukë vdes.

Jak’o dit’e uruar!
Që lind nga perëndon,
At’an’e ke ndrituar
E ne pse na haron?

Dritëz’e jetës!
Edhe e motit
Dhe e së vërtetës,

Dhe gaz’i Zotit,

Ndritëna

E xgjohna.

ZËMËRA

Fuqi’ e Perëndisë

Duketë tek do,

Se shpirt’i gjithësisë

Po është ajo.

Ajo është gjithë ç’janë,

Është në çdo vënt

E duket më ç’do anë,

Në trup e në mënt.

E shohëmë në qiej,

Në shi e në rë,

Ndë hen’e në për diej

Ësht’ edhe në dhë.

Më tepër zemrën tënë

Atë ka për fron,
Nuk ja dëgjon zënë,
Zemrën s’e dëgjon?

DIT’E ZEZË

U gdhi një ditë, një dit’e zezë,
Engjëllit’ gjithë me lot po qanin,
Përpara Zotit shihnin një rezë,
Rrinin tmeruar edhe zi mbanin.

Dheu qe mbuluar ane një errësirë,
E tërë bota ish egërsuar,
Dielli e hëna ishin nxirë,
Qielli ishte i trubulluar.

Ish bërë sterrë tej-për-tej jeta,
E ishte një tmer, tmer i mërzitur,
Se kishte humbur gjith’e vërteta,
Se gjithë bota isht’e mahnitur!

Paudhësija dhe ligësija
Ishte bërë mbret mbi det të shkretë!

Dhe të këqijat e padija
Kishin zënë vënt për të vërtetë!

Ish një mynxyrë mbi njerëzinë!
Sepse gënj eshtra po prist’e qepte,
E kish verbuar fare njerinë,
Edh’ e vërteta po mirt’e jepte.

Dritëz’e bukur e Perëndisë
Nd’anët e rripës kishte qëndruar,
Dhe errësira e ligësisë
Nga të gjith’anët e kish rrethuar.

Lufton gënjeshtra me të vërtetën,
Dhe errësira dritën luftonte,
Që t’erresonte së gjithash jetën,
Dhe djallëzija të mbretëronte.

Po derdhej gjaku, gjak i bekuar,
Qjelli kish hedhur cipën e zisë.
Përpara syve të Perëndisë,
Ëngjëjtë qanin duk’e tmeruar.

Yj edhe qiej! qysh s’u-rrëzuatë?
E si s’u bëtë cop’e thërime?
Diell e Hënë për se qëndruatë?
E nuk’u bëtë si zëmra ime?

Zot i jetës, shumë durove,
Shumë durove, o zëmër-gjërë,
Po na të gjorët na përvëlove,
Na perzëllite zemrën e mjerë!

Njeri i ndyrë, komb’i mërzitur!
Imam Hysenit i heth shëgjetë?
Nukë di se ç’bën, je i mahnitur?
E kë godit kshu? Zotn’e vërtetë?

BESOJMË

Besojmë Zotnë q’ësht’ i vërtetë,
Se gjithë ç’shahem ësht’ ay vetë,
Dhe falëtore kemi njerinë,
Atje e gjejmë dhe Perëndinë.
Ëngjëllë thuhetë vetij’e mirë,
Dhe djalli është pun’e pështirë.

Njeriu s’vdes’ po vetëm ndërrohet,
Dhe shpirt i ndyrë kurrë s’gëzohet.
Njerin’e bëri Zoti të lirë,
Po duhet kurdo të bënjë mirë,
Dhe i dha mëndjen që të peshonjë.
Dhe të paudhat t’i largësojnë.
Të mos përflasë, të mos qërtonja,
Të jet’i urtë, me nder të rronjë,
Shpirti na thotë të bëjmë mirë,
E të rnos kemi kurrë dëshirë,
Për të këqia kurrë në jetë,
Të jemi t’urtë e të vërtetë.
Fort lark të jemi nga marrëzija,
E të mos rrojmë si bagëtija.
Falje ne kemi vëllazërinë
Dha dashurinë e njerëzinë,
Se udh’ e drejtë e Perëndisë,
Nuk’ është tjatrë, veç njerëzisë.
Po të nderojë njeriu njerinë,
E ka nderuar dhe Perëndinë
Në zëmrët tënë e gjejmë Zonë,
Shtëpi e tij është zëmra jonë.
Të dil në shesh desh Zot’i vërtetë,

Bëri njerinë dhe atje është vetë.

Një njeri që njeh vethen e tija,

E di se ç’është dhe Perëndija.

UJËT E BEKUARË

Ejani këtu, o shokë,

Mblidhuni kokë për kokë,

Pini të bëhem trakë,

Të na shohë Perëndija!

Këtej e tutje s’gënjehem,

Me të rreme më s’rrëmbehem.

Dua të pi e të dehem,

Ku është vera dhe rakija?

ujthit’e bekuar!

Nga qjelli na ke buruar?

Zot’i math të ka dërguar

Që të çelçë zemrën tënë?

Lule mbijn’ tek pikon tinë,

Ti na bje batbardhësinë

Edhe gasthin’e gaxhinë,
Haps’i tyre t’është dhënë.

Ti neve na e bje nderë,
Nga mendimet duke nxjerë,
Na fluturon nëpër erë,
E na pjek me Perëndinë!

Gjithë ç’janë na mundojnë,
Shpirtin na e përvëlojnë,
Na tretin e na kullojnë,
Vetëm ti e do njerinë.

Dashurinë duke mbjellë,
Dhe këngëtë duke pjellë,
E gas të math duke sjellë,
Mjerësija na mbulohet.

Të këqijatë harrohen.
Dhe mejtimetë s’mbarohen.
Edhe brengatë s’mejtohen,
Njeriu qesh e gëzohet.

Jakënl, shokë, të rrimë,
Rreth druvezes’e të pimë,
Se të nesërmen s’e dimë,
Na arriti pleqërija.

Koha po shkon e më s’kthehet,
Njeriu i zi gënjehet,
Me punë të rrema merret,
Dhe e mbulon babëzija!

Gjithë jetën nukë rrojmë,
Shpirtinë pse t’e mundojmë?
Pa qasuni të këndojmë,
Se na plasi buz’ e shkretë.

Shkel e shko zëmëra ime.
Mos bjerë në hidhërime,
E në breng’e në mejtime,
Mos të gënjenjë kjo jetë.

PËRPARA KRISHTITË

Djalëth njeriu i Perëndisë

Fytyra jote mua më tregon
Ah! të këqijat’e njerëzisë,
Që ka punuar edhe punon.

Se kjo fytyrë
Është pasqyrë,
Dhe na rrëfen,
E s’na gënjen.

Gjithë ç’ka hequr njeriu i mjerë
Nga veth’e tinë a nga i vëllaj
Që kanë vrarë e kanë prerë
Pa gjyq, pa fjalë, pa pasurë faj.

Zot, ti ke vuar
Edhe s’ike pushuar,
Nga njeriu hoqe,
Për të u përpoqe.

Ti u përpoqe për njerëzinë,
Dhe dashurinë e bëre besë,
Njeriut vure nam miqësinë.
Që kur të lindet gjer sa të vdesë.

Për këtë fjalë
Të qofsha falë,
Se njerëzija
Ë Perëndija.

ZONJ'E FATIT

moj plaka lozonjare,
Që ndjek fatn'e njerëzisë,
Dhe mas'e pesh s'ke fare,
Po me shkop të marrëzisë.

Moj, po me ç'sy e me ç'faqe
Më qasesh prap'e më çfaqe?

Të shoh që vjen po si hie
Niga dale, si qen i qetë
Edhe hi syvet më shtie
T'u thaft' ajo dor' e shkretë!

Ata sy të zgurdulluar
T'i shoh, o e mallëkuari

S’je e verbërë si thonë,
Që s’sheh, s’di se ç’bën në jetë;
S’je e shurdhër, pasha Zonë!
Dëgjon posi djalli vetë,

Po je e keqe dhe shtrigë,
E pahes’e zëmër ligë!

Ti f jalëtë i ke kthyer,
Pandaj na ke përvëluar,
A! popo! ç’na ke gënjyer!
Njeri s’të ka trashëguar.

Dhe kur ndrin, ndrin si lugati,
Pandaj s’të ka qëndrim fati.

Jakë, se jam dëshëruar,
E më s’e duroj dot vrerë,
Qesh, mos rri e zemëruar,
Makar për një copë herë.

Qesh një herë, o leshra krënde,

Me të qarë nuk’u dënde?

ABAZ — ALIU

Engjëll! që m’u qasë pranë
Nga i madhi Zot,
Pse më rrëfen Qerbelanë?
A do të derth lot?

moj fush’e Qerbelasë!
Që më rri ndër sy,
Plot me gjak t’Ali-Abasë,
Vallë ç’ësht’ ay?

Ç’ësht’ ay që shkon kaluar,
Ikën si veriu,
Me dy-tri foshnja nër duar?
Ësht’ Abas-Aliu!

Shpije foshnjatë në lumë,
Se s’durojnë dot,
I ka marrë etja shumë,
E qajnë me lot!

Ujët ua kanë prerë
Janë në shtrëngim,
Si të varfër e të mjerë.
Në zi, në hidhërim.

Më ç’do an’ i ka rrethuar
Kombi faqezi,
Komb’i lik i xnallëkuar,
Posi mizëri!

Nëpër mest të ushtrisë
Të armikut shkon,
Si ëngjëll i Perëndisë,
Nd’erë fluturoni

Shigjetat si breshërimë
I vinë ngado,
Ay po si vetëtimë
Ikën nëpër ’to.

Shërbtor’e njerëzisë
Shigjeta s’e çpon

Edhe nder’e trimërisë
Zoti e mburon.

Ç’ikën ay kal’i shkretë,
Mi dhë nuk shkel
Nga potkonjtë q’ikën shpejtë
Zjar e flak’i del!

moj kafshëz e uruar,
Mos shkel për mi dhë.
Se’shtë gjaku i bekuar,
Ikë nëpër rë!

Frat, o more lum’i shkreti
Mos këndo pa qaj,
Derth lot e rënko për jetë,
Mos qesh paskëtaj;

Se Hysejn’e Fatimesë
Me faret të ti,
E vranë komb’i pabesë,
Kombi faqezi.

Abas Aliu zu’ Tomorë,
Erdhi afër nesh,
Shqipërija s’mbet e gjorë,
Se Zoti e desh.

Hysejni desh njerëzinë,
Dhe për të u vra,
Për të shpëtuar njerinë
Ra nde Qerbela.

Hysejni ’shtë dashurija
Që fatbardhëson,
Buron soje miqësija,
Qe na lartëson.

Jeziti ’shtë egërsirë,
Që sjell ligësi,
Dhe s’del soje pun’e mirë
Po dëm edhe zi.

Kushdo që bën mirësinë
E ka njerëzi
Ka besuar Alinë,

Dhe udhën e ti.

Gënjeshtra ’shtë Mavijeja,
Që prish edhe sot,
E drejta ’shtë Fatimja,
Dhe i madhi Zot.

E liga është Mervani
Që nxin e shkretën,
Djallëzija ’shtë Syf jani,
Që dhe sot dërmon.

Imamëtë dymbëdhjetë
Nga der’e Aliut,
Hoqn’e vuanë ndë jetë
Por nder të njeriut.

Zotërinj! ju qofsha falë!
Që hoqtë për ne,
Na latë vetëm një fjalë
Për bes’e fe.

FYELLI

Pa dëgjo fyellin ç’thotë
Tregon mërgimet e shkreta,
Qahet nga e zeza botë
Me fjalë të vërteta.

Që kur se më kanë ndarë
Nga shok’ e nga miqësija,
Gra e burra kanë qarë
Nga ngashërimet e mija!

Krahërore e kam çpuar
E kam bëre vrima vrima,
Dhe kam qar’ e kam rënkuar
Me mijëra psherëtima!

Dhe me botën e gëzuar
Bëhem shok edhe marr pjesë,
Dhe me njerës të helmuar
Bënem mik me besa-besë.

Puna si do që të bjerë
Unë qanj me mallëngjime,

Më çdo vënt e kur-do-herë
Psherëtin zëmëra ime!

Gjithë bota më dëgjojnë
Po së jashtëmi më shohin,
Dëshirën s’m’a kupëtojnë
Zjar’ e brendëshmë s’m’a njohim.

Njerëzit me mua rrinë,
Unë qanj’ e mallëngjehem,
Po dufn’ e pshehtë s’m’a dinë
Andaj kurrë s’përdëllehem.

Gjith’ ata që janë ndarë
Fyellit shokë ju bënë,
Shkallët’ e tij disa farë,
Na shkalluan mëndjen tënë.

rrëmet i njerëzisë!
Zër’ i fyellit s’ësht’ erë,
Ky ësht’ zjarr’ i dashurisë
Që i ra kallamit mjerë!

I ra qiellit e ndriti,
I ra zëmrësë e nxehu,
I ra verës e buçiti,
I ra shpirtit, dhe e dehu.

I dha erë trëndafilit
I dha dritë bukurisë,
I dha këngëtë bilbilit,
I dha shije gjithësisë.

Ay zjar i ra në qiej,
Edhe duke përvëluar,
U bënë kaq yj e diej,
Që i mba Zoti ndër duar,

Nga ky zjar Zot' i vërtetë,
Që ka ngehur gjithësinë,
Hoth një shkëndijë në jetë,
Dhe bëri soje njerinë.

more zjar i bekuar!
Unë me ty jam përzjerë,
Pa jam tretur e kulluar,

Po të kam shpirt, mos më lerë.

ZËMËRA

Retë kur bënenë sterrë
Edhe era kërcëllimë,
Dheu bënetë skëterrë
Edhe qjelli vetëtimë.

Zë një shi me rrëmbim shumë,
Që zbret nga ret’ e mbyt dhenë,
Bje qiejshit si lumë,
Pa vete të gjejë denë.

Vinë përrenj t’e rrëketë,
Edhe uj’ i trubulluar
Vë përpara ç’gjë të jetë,
E ç’gjen mb’ udhë duke shkuar.

Ashtu dhe zëmëra ime
Nxjerr gjëmim’ e vetëtima,
Zjar e flak’ e mallëngjime,
Derth gjaknë me psherëtima.

N’avull ngrihetë përpjetë
Prej zëmërsë ngaha zjari,
Edhe lotët si rrëketë
Derdhenë syvet së qari!

miz’ e mbyturë nd’ ujë!
Djell’ i shpresësë në daltë,
Do pushonjë kjo rrëmujë,
e nukë mbetesh në balte.

Shiu bje, dheu gjelbërohet,
Dhe vera vjen e gjen varrë,
Varri me fletë mbulohet
Dhe rrëkeja shkon t’a marrë!

det i thell’ e pa anë!
Që ke mbrenda gjithësinë,
Nga ty dalin gjith c’janë,
Edhe prapë tek ty vinë.

Gjer sa të vinj’ e të bjerë
Pik’ e shpirtit t’im si lumi,

Në det të math e të gjerë

Zemrën t’ime s’e ze gjumi.

TË VDEKURITË

Jakë, mejtim, jakë,

Dua të mejtohem,

Të rri të qetohem,

Edhe të qanj pakë.

moj koh’ e shkuar,

Kurdo që të kujtonj,

Përsëri e lëndonj,

Zemrën e lënduar.

Vallë ku na vanë,

Gjithë ata shokë,

Q’i patëm mi kokë

Ku jan’, ah! ku janë?

Qysh humpnë për jetë,

Edhe më s’i pamë?

Ah! me ’ta pse s’vamë

Na lanë të shkretë!

Kur ishin të gjallë,
Sa shumë i donim,
Me një shpresë rronim!
Si të mundim vallë?

Pa qysh t’i harrojmë?
Zëmra s’na duron
Shpirti ndaj kërkon,
Pa ’ta si të rrojmë?

Të gjith’ një qemë,
E një zëmër kishim,
Gjithë në shpirt ishim,
Neve pas pse mbemë?

Të shumët’ u ndanë,
Po vallë ku vanë?
Për jet’ u mërguan?
A po u ndryshuan?

Ndër sy po më rrinë!

Ah! sikundër qenë,
Më vjen sikur flenë,
Pandeh se do vinë.

I kam ndër mënt dhe sot
Me shtat, me fytyrë,
E zeza mynxyrë!
Të arthtë keq, o Zot!

Më vjen shumë herë
Sikundër do të vinë,
Të gjejnë shtëpinë
Ata dhe një herë.

Të na përqafojnë,
E diç të na thonë,
Si kishim zakone,
Dhe me ne të rrojnë!

Po kur më kujtohet,
Që janë të vdekur,
Në dhet janë tretur,
Zëmra më tmerohet.

I kemi mbuluar,
Ah! në dhet të shkretë,
Njeriu në jetë
Lintka për të vuar!

Lint me ngasherime,
Rron me hidhërime,
Heq shumë mundime,
Vdes me psherëtime,

Dhe gjer sa të vdesë,
Rrihet e përpiqet,
Kurrë nuk’ i hiqet
Dhe e shkreta shpresë.

Zëmra na ’është vrarë,
Dy copa ’shtë bërë
S’e kemi të tërë,
Se dy është çarë.

Një copë ka shkuar
Dhe ka zënë varrë,

Ng’ ata është ndarë,
Ndë dhë ’shtë mbuluar,

Zot i vërtetë!
Me sa hidhërime
E me ç’mallëngjime
Rron njeriu n’jetë!

Të dashurit tanë
Dheut krahët shtruan!
Na e përvëluan
Zemrën, na e ndanë.

I kemi mbuluar
Po shpirti që s’vdes,
S’ka mbrëm’ e mëngjes,
Ku ka fluturuar?

Se vdekja s’e zë dot,
Po ku vallë qëndroj?
Në burimt të tij shkoj,
A, tek i madhi Zot?

Si lumi që këlthet
Me shum’ oshëtimë
E me ulërimë
Vete prapë në det.

Munt të na bashkojnë
Krahëthit’ e vdekjes,
Ku ’shtë vënd’ i pjekjes,
Ndër ’ta të na çojnë.

Këtu duhet besa,
Mendje pa pusho,
Se zëmra m’a do,
Dhe s’më pritet shpresa.

Kush dha hidhërimnë,
Na dhuroj dhe besën,
E të kemi shpresën,
Kur heqim mundimnë.

U kam shumë mallë,
Këtu më s’i shoh dot,
Shpreh nek i madhi Zot,

Do t’i gjenj të gjallë.

Vdekja po na thërret!
Sado të mënojmë,
Varr’ i ftohtë na pret,
Atje do të shkojmë!

Si lum ajy që rron
Njeri i vërtetë
Në jetë të shkretë,
E shpirtin s’e helmon.

Pa lulet q’u-thanë,
E nuk’ i shohëm sot,
Vinë prapë mot,
Shpirtin gjali’ e kanë.

BILBILI

Hëna plot pesë-mbëdhjetë.
N’anët të qjellit po ndrin,
Bota është gjith’ e qetë,
Gjësendi nuk’ pipërin.

Qielli ësht’ i qëruar,
I kulluar po si ari,
I fjetur e i qetuar,
Syri s’nginjetë së pari.

Ka rrjedhurë si uj’ ergjëndi
Më të gjith’ anët një dritë,
Dhe prej soje gjithë vëndi
Është bërë posi ditë.

Buruar një uj’ i artë,
E dhen’ e ka xbukuruar,
Majat’ e malit të lartë
Dhe gërxhet i ka zbardhuar!

Mi brigj’ e mi shesh’ e drurë,
Dhe përmi det drita bije,
E mi shkëmbënj e mi gurë.
Dhe vise që jan’ në hije.

Nata është fort e qetë,
Dhe gjith’ i ka zënë gjumi,

Vetëm përrenj t’e rrëketë
Ligjerojnë, edhe lumi,

Që oshëtin duke shkuar,
Nxjer një zë plot ëmbëlsirë,
Dhe ikën duke kënduar,
Sa vete bukur’ e mirë.

Veriu fryn pakë nga dale,
Njerës, kafshë, shpes’ e fletë,
Pyje, shkëmbinj, fusha, male,
Të gjithë janë të qetë.

Maji ka sjellë nga Zoti,
Shumë bekim e urata,
Është xbukuruar moti,
Dhe n’ar’ është veshur nata.

Lulet kanë lulëzuar,
Vjen një erë fort’ e mirë,
Drurëtë janë ngarkuar,
Dhe barratë kanë mbirë.

Dhitë, kecërit e dhëntë
Edhe shqerat jan’ tulitur,
Rrinë zgjuar vetëm qëntë,
Nëpër ledhe janë shtritur.

Se nga dëgjonet thëllëza
Që thotë tri katër fjalë,
Nëpër brinj’ e nëpër rrëza,
Dhe deti ka pakë valë.

Një zë tjatër tani dëgjonj!
Që zëmrënë m’a përvëlon!
U-doqçë, më s’munt të duronj!
Bilbili ka zën’ e këndon!

Qiej, yj e dhë, pushoni,
Tani juve kush u dëgjon,
Vini veshn’ edhe dëgjoni,
Bilbili, bilbili këndon.

bilbil! e di se ç’dua,
Andaj zëri i bukur yt,
M’a dogji shpirtinë mua,

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-

Edhe gjumë s’më hyn në syt!

NJË LUL’ E VISHKURË, A NJË VASHËZ’ E VDEKURË

Pse mba mëri? s’e mar dot vesh,
Përse s’më flet si një herë?
Pse s’më shikon? pse nukë qesh?
Ç’rri kok’ unjur dhe e mjerë!

Sa e qeshur më qe dije!
Të xbardhte gusha si kartë;
Buza me gas ç’të kish hie!
Më ishnje si fill’ artë!

Popo! si më je shëmtuar!
Të ka zënë varfërija,
Më je tretur e kulluar!
Ku fluturoj bukurija?

Të shoh të fishkurë për dhë,
pa shpirt, pa gjak, pa fytyrë,
Na le, o lulezë, na le!
vdekje! ç’je një mynxyrë!!

Që lott’ e syvet s’i shikon,
S’vë vesh në mallëngjime,
Je e shurdhër, nukë dëgjon,
Ah! je plot me hidhërime!

Sa na dhemp e shkreta jetë!
Ndonëse nuk’ e pëlqejmë,
E pandehini të vërtetë,
Me gjësendi s’e çkëmbejmë!

Të korr’ o lulez’ e gjorë,
Të hedhë në jetet tjatër,
E nga neve hoqe dorë!
Më s’na ke t’ënt’ as të afër!

Ah! dh’ ata që kanë shkuar,
Zëmërnë zhur na e bënë,
E kemi të përvëluar,
Zëmra prej guri s’ka qënë.

Paskëtaj buza më s’më qesh,
Se zëmra m’ësht’ e lënduar,

Zot’ i vërtetë! të më ndjesh,
Jam djegur e përvëluar.

Qiej! veshuni në të zi!
Edhe ju yj më mos ndrini!
hënë, mos del përsëri!
Gjithë të helmuar rrini.

Nxihu, o diell’ i shkretë!
Ditë, rrobën’ e natës hidh!
Thahu e ti po dhë për jetë,
Ti lumë, qetohu, mos klith.

Të mbarohetë kjo jetë!
Të mbretëronjë pushimi!
Të bijemë në të qetë!
Të gjenjë funt hidhërimi!

Rrojmë këtu me mundime.
Me ah, e me psherëtima,
Me breng’ e me mallëngjime.
Me vaj e me ngashërima.

Më së fundi hyjmë në dhet,
Edhe kurrë më s’na gjejnë!
Bijem e humbasëm në det,
Dhe valëtë na rrëmbejnë!

Të rrëmbyen edhe tynë,
lulez’ e bukurisë!
T’a sheh të venitur synë,
Më ke fytyrën’ e zisë!

Kur dhë shpirtinë ti pshonje,
Me një psherëtimë si zjari,
Gjithë ç’jan’ i përvëlonje
Nukë mbetej as një fill bari.

Vallë ku do të të shpijen,
Në qiej, përpara Zotit?
A kërkojnë të të shtijen
Prapë në duart të motit?

Të linç për të vdekur prapë,
E të vdeç, që prapë të linç,
Edhe kështu vër’ e vapë,

Gjithënjë të veç’ e të vinç?

A po për jetë do të shkosh,
Mosqënja të të mbulonjë,
Edhe ti jetën fa harosh,
Dh’ ajo ty të haronjë?

GJUHA JONË

Vëllezër Shqipëtarë!
Të prekim urtësinë,
Të zëm’ udhën’ e mbarë,
Të ngjallim Shqipërinë.

Shqipërija ka qënë,
Edhe po do të jetë,
Po sot në ditët tënë
Të metë të mos ketë.

E ka nderuar Zoti
Gjithënjë Shqipërinë,
Ish fort mirë qëmoti,
Do bëhet dhe taninë.

Sa ishte trimërija
N’atë kohët të vjetrë,
Kish emrë Shqipërija,
Sa s’kish nonjë vënt tjetrë.

Sa burra kordhëtarë
Ka nxjerrë Shqipërija,
Më pastaj e më parë
Q’i shkruan Istorija.

Ajo ish koh’ e zjartë,
Dhe kish mundime tepër,
Po sot pendë dhe kartë
Na duhet, nukë tjetër.

burra Shqipëtarë,
Të marim dituritë,
Se s’ësht koh’ e parë,
Tani lipsetë dritë.

Të shkruajm gjuhën tënë,
Kombinë t’a ndritojmë,

Gjithë ç’ësht’ e ç’ka qënë
Nga dalëzë t’a msojmë.

Pa shihni ç’gjuh’ e mirë!
Sa shije ka e hije,
Ç’e bukur’ edh’ e lirë,
Si gjuhë Perëndije!

Shum’ e bardhë kjo ditë
Për gjithë Shqipëtarët,
Do na sjellë një dritë,
Që s’e kishin të parët.

Kjo dritë do na bjerë
Të gjitha mirësitë,
Dhe gjithë dot’ i ngrerë
Dëmet’ e marrëzitë.

Si lum kush zë të mbjellë!
Lum kush vë bëtë pemë!
Se kjo ka për të pjellë,
S’mbulohetë me remë.

KORÇA

vëllezër Shqipëtarë!
Gëzohi! që erdh kjo ditë,
Kaq’ e mir’ e kaq’ e mbarë,
Që sjell gjithë mirësitë.

Kjo është dit’ e rëzë,
Që bije vëllazërinë,
E dëbon jetën e zezë,
Dhe ndarjen’ e marrëzinë.

T’a lusimë këtë ditë
Që bekoj Zot’ i vërtetë,
Dh’ e dërgoj me shumë dritë.
T’i mbes emëri për jetë.

Sot e vumë gurr’ e parë.
E bekuar ësht’ kjo ditë,
Zot’ i madh e pruftë mbarë,
E na dhëntë urtësitë!

Hapu, Lapu errësirë!

Pa jakë tëhu o dritë!
Se arriti koh’ e mirë,
U gdhi nata u bë ditë.

Sot niset një tjatrë jetë,
Të rremenë posht’ e shtije,
Mbretëron f jal’ e vërtetë
Dhe të mirat gjith’ i bije.

Zot’ i math qoft’ i lëvduar!
Q’e nxjer në shesh të vërtetën,
Se ajo sij ka buruar,
Pa e ka ndituar jetën.

Lumja ti, moj Korç’ o lule,
Q’i le pas shoqet e tua,
Si trimi në ball’ u sulë,
T’a paçim për jetë hua.

Kushdo që është sot burrë,
Dhe Shqipëtar i vërtetë,
Emëri s’i shuhet kurrë,
Dhe nderi i rron per jetë.

Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmbël! sa e gjerë!
Sa e lehtë! sa e lirë!
Sa e bukur! sa e vlerë!

Kjo’ shtë mëm’ e mirësisë
Që bije qytetërinë,
Gasthin’ e vëllazërisë,
Njerëzin’ e miqësinë.

S’jemi Grekër as Bullgarë,
As gjë tjatër nukë jemi,
Jemi vetëm Shqipëtarë,
Një këtʼ emër nder’ e kemi.

Ky emr’ është shum’ i mirë,
Se më s’jemi të gënjyer,
Nuke jemi n’errësirë,
E njohmë gjen’ e vjyer.

Perëndija na e lënte!
Për jetë t’a trashëgojmë,

Edhe kurrë mos e dhëntë!
T’a humbim a t’a harrojmë.

Të lemë mëmënë tënë
E të marimë një shtrigë!
Zoti mos e pastë thënë!
Pun’ e keq’ e shum’ e ligë.

O! sa qenë të gënjyer,
Ata që vuan për botë,
Turp të math kanë rrëfyer
Punuanë fare kotë.

Pa mejtoni, o të gjorë,
Efialtin, Pafsaninë,
Që u bënë trathëtorë,
Dh’ e gjënë më Perëndinë.

Nga gjithë ç’kemi kënduar,
Për të njohur vetëhenë,
Kaqë gjë kemi mësuar:
Të nderojmë mëmëdhenë.

Se njerzit gjithë vdesin,
Po jeta s’mbetet e shkretë,
Gjuha, Mëmëdheu mbesin,
Të patundura për jetë.

Me zëmërë të gëzuar,
Dhe me gjithë shpirt uroni!
Zotërinjt’ e Zotëruar!
Gjithë përnjëherë thoni:

Rroft’ e qoftë Shqipërija!
Dhe kombi e gjuha jonë
Lulëzoftë diturija!
Edhe ndihmës paçim Zonë!

Edhe Sulltanit të mirë,
Mbretit t’math q’e kemi atë
Dhe ka për neve mëshirë
E përpiqet dit’ e natë.

Zoti jet’ e dit’ të dhëntë
Dhe qëllimet ja mbarofte!
Me nder përmi front e lënte!

Dhe gjithënjë e gëzoftë!

PERËNDIJA

Ç’sheh ësht Zot’ i vërtetë,
Ç’dëgjon është zër’ i tija,
Gjithë ç’ka e s’ka në jetë
Është vetë Perëndija.

Mos shiko valëtë p’anë
Mos të gënjenjë rrëmeti,
Të tëra një burim kanë,
Gjithë ngrihen pej një deti.

Në det të math e të gjërë,
Çdo valë, që të sheh syri
Atje është det’ i tërë,
Po valëtë mirë qyri.

Kur fa zësh gjënë të bërë,
Ësht’ ashtu me të vërtetë,
Po t’a vesh re gjat’ e gjërë,
Ësht’ ajy bërësi vetë.

Dhe kush flet, edhe ç’gjë flitet,
Ç’duket e s’ duket në jetë,
Dhe kush sheh, dh’ ajo që shihet
Zot’ i vërtet’ është vetë.

Se e tërë gjithësija,
Që nuk’ i gjëndetë fundi,
Është vetë Perëndija,
Për atë s’ka vënt gjëkundi.

Është në shesht Perëndija,
I verbër! s’munt t’a shohë,
Ajo është gjithësija,
I dituri munt t’a njohë.

Pe një lulezë kur shohim,
Dhe të vëmë re një fletë,
Me dituri, t’a njohim,
Q’atje ’shtë Zot’ i vërtetë.

Është në shesht Perëndija,
Sicili do munt, t’a njohë,

Po s’e mbuloj e padija,
Njeri tekdo munt t’a shohë.

Kush do t’a shohë të tërë,
Të shohë mirë njerinë,
Vethen’ e tijre të vërë,
Atje gjen Perëndinë.

Dhe Parajsi dhe Skëterra,
Dhe engjëlli edhe djalli,
Edhe gjithë ç’ka të tjera,
Janë mbrenda tek i gjalli.

Ajy që ka mirësinë
Ka Perëndin’ e të mirat,
Edhe kush ka djallëzinë,
Ka djallë e ligësirat.

Më çdo anë e kërkova,
Thashë, ku ’shtë Perëndija?
Po më pastaj e mësova,
Qenka ndaj mej’ e s’e dija!

Kërkonja gjetkë t’a gjejë
Zotn’ e math e të vërtetë,
Ajy qënëkej ndaj meje,
E paskësha unë vetë!

Me fjal’ e me agjërime
Nuk’ e gjen dot Perëndinë,
As me kreshm’ e me kungime,
Si punojn’ ata që s’dinë.

Trajstën’ e ke plot me bukë
Edhe hiqesh si i mjerë,
Dhe ke zën’ e thua nukë
E lipën derë më derë!

Është ndaj teje i gjallë,
Ti e kërkon nëpër gurë,
Në të rrem e në përrallë
Andaj nuk’ e gjen dot kurrë.

Pa s’vdes kurrë Perëndija
Po kush vdes në jetë vallë?
Gjë s’vdes, sepse gjithësija

Është gjithënjë e gjallë.

Qeshë diellë, ishnja hënë,
U bësh’ uj’ e balt’ e erë,
Yll e zok e dash kam qënë
Pa dhe njeri shumë herë.

Sa det i math e i gjerë!
Edhe sa mijëra valë,
Si-cil’ atje do të bjerë
Prapë soje do të dalë.

Mijëra shpirtëra ngrihen,
Bijen mijëra të tjera,
Vjen dimëri, lulet pshihen,
I nxjer prapë në shesht vera.

Nj’ është, po ka shumë gjyrë
Duket sikur s’ka të ngjarë,
E sheh fytyrë fytyrë
Po ’shtë i njëjt’ e i pandarë.

Ajy është trëndafili

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-

Edhe gjemb’ i trëndafilit,
Ajy është dhe bilbili,
Ajy dhe zër’ i bilbilit.

Mos shiko ç’rrobe ka veshur
Është mbrënda vet’ i qetë,
Syr’ i t’urtit e sheh çveshur
Veç ati s’ka gjë ndë jetë.

Zoti është gjithësija
Ay është gjithë ç’janë,
Po kush njeh vethen’ e tija
S’e kërkon më tjatër anë.

Dhe qelqeja u-hollua
Dhe vena pa u përzjenë,
S’ka ven’ është qelqe thua
A s’ka qelqe, është venë!

Unë ndaj teje një pikë?
det i gjër’ e pa anë!
Të hynj brënda! më vjen frikë!
Po s’hiqem dot dhe më nj’ anë.

Të kisha zën’ e bilbilit
Gjithënjë do të këndonja
Bukurin’ e trëndafilit,
Dhe kurrë të mos pushonja!

Po ti vetë je, o bilbil.
Ti je edhe dashurija,
Ti je edhe trëndafili
Edhe bukuri e tija.

Ti je ç’është jet’ e tërë
Ti je vetë gjithësija,
Ti vetë njeri je bërë
More fytyrën’ e tija!

Oh! det i madh, i pa-anë,
Në një stamnë qysh ka hyrë?
Ay q’është gjithë ç’janë!
U mblodh tok më një fytyrë?

Më çdo anë që shikova,
Pashë mirë që je vetë,

Të gjeta tek të kërkova
Zot’ i madh e i vërtetë!

Prej trupi shpirt është bërë,
Edhe shpirti trup në jetë,
Është bërë një i tërë
Gjithë ç’është është vetë!

Paskëtaj, o shokë, kurrë
Mos kërkoni Perëndinë,
Nëpër mur’ e nëpër gurë,
Po shihni mirë njerinë!

Zemr’ e njeriut në jetë
Është vënt’ i Perëndisë,
Ësht’ atje Zot’ i vërtetë
Det’ i madh i gjithësisë.

Ay është gjithësija
Edhe udh’ e Perëndisë,
Është vetëm njerëzija
Q’i duhetë njerëzisë.

Merr’ dorën e diturisë
Pa ajo do të nxjerë
Gjer te fron’ i Perëndisë,
Ndaj soje do të të shpjerë.

Ësht’ e vërtetë kjo punë
Mos qëndroni n’errësirët,
Se këtë s’e gjeta unë
E kanë thënë të Mirët.

SHPREH

Kam shumë shpresë
Te Perëndija,
Që të mos jesë
Kshu Shqipërija,
Po të ndritohet
Të lulëzohet.

Pa vjen një ditë
Që të na sjellë
Të madhe dritë
P’ ajo të pjellë:

Qytetërinë,
Fatbardhësinë.

Vëllazërija
Edhe bashkimi
E njerëzija
Është shpëtimi,
Lum kush t’arrinjë!
Pa do të vinjë.

Që Shqipërija
Do të ndritohet,
Dhe ligësija
Do të mërgohet.
Jak’ e vërtetë!
Pse rri e qetë?

Për Shqipërinë
Ditët e mira
Paskëtaj vinë
Shkoj errësira,
Lum kush të rronjë,
T’a shohë zonjë!

Se Shqipëtar!
E gjuh’ e tija
Venë së mbari
Dhe Shqipërija,
Lum kush t’a shohë
Për pakë kohë.

Pa dituritë
Dhe mbrothësija
E mirësitë
Dhe njerëzija,
Do të burojnë
Nuke mënojnë.

TRADHËTORËT

Shokë! kemi në mest tënë
Shum’ armiq’ e tradhëtorë!
Popo! mos u qoftë thënë!
Veç që s’kanë gjë në dorë!

Haruanë Mëmëdhenë!

Dh’ e lanë kombinë tënë!
E një tjetërë na gjënë!
Popc! mos u qoftë dhënë!

Lanë Zonjën’ e lëvduar!
E zunë një kurvë shtrigë!
Të ndyr’ e të mallëkuar!
Të fëlliqur’ e të ligë!

Lanë Mëmënë të çveshur!
Dhe mundohenë për botë!
Pa dhe bota duke qeshur
U thotë, mundohi kotë!

Qysh u bënë Efialtë!
E nuk’ e njohin të mirën,
Uthullën pandehin mjaltë
Edhe dritë errësirën!

Buk’ e Mëmëdheut i zëntë!
Tradhëtorët’ e pabesë,
Dhe Zoti dërmën u-dhëntë,
Kurrë mos paçinë pjesë!

Miqt’ armiq i kanë bërë!

Armiketë miq i zunë!

Qysh janë fyell të tërë!

Ç’është kjo e madhe punë!

Fajn’ e madh kur do t’a njohin

Njerëzit e mallëkuar?

Dritënë pse nuk’ e shohin?

Apo janë të verbuar?

Janë së gjithash të marrë!

Dhe të liq me të vërtetë,

Mëmëdheut bëjnë varrë,

Po do të bienë vetë.

Se mbretëron e vërteta,

S’del kurrë gënjeshtr’ e shkretë,

T’ish ashtu, qe prishur jeta,

S’kish mbetur gjë e vërtetë.

Ata turpinë fitojnë

Nder’ e tyre posht’ e hedhin,

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-

Dhe armikëtë gëzojnë
E në errësirët bredhin.

Nuk’ është kurrë harruar
E mira dh’ e lig’ e shkretë,
Të gjitha janë paguar,
S’ka mbetur gjë në jetë.

Lerini, pa do t’a gjejnë
Të vërtetën do t’a njohin,
Se tani s’e dinë ç’bëjnë,
Jan’ të verbër’ e nuk shohin.

O! popo, ç’turp kanë marrë!
Janë bërë tradhëtorë!
Dhe s’janë më Shqipëtarë
Se nga kombi hoqnë dorë!

Me të huajnë u-bënë!
Me armikn’ e Shqipërisë!
S’duanë gjuhënë tënë
Armikëtë e Perëndisë!

Ndjej’ o Zot se nukë dinë
Se ç’bëjnë, janë mahnitur,
Rrahin të prishin shtëpinë!
Pun’ e lig’ edh’ e mërzitur.

Të gjorët janë në gjumë!
Të vërtetënë s’e dinë,
Do të mundohenë shumë,
Pastaj mëntë do t’u vinë.

Vëllazërin’ e harrojnë
Dhe kombin e mëmëdhenë
Dhe armikëtë dëgjojnë!
Edhe s’dinë se ku venë!

Hiqni dorë, hiqni dorë!
Mblidhni mënt’ e turpërohi,
Mos u-bëni tradhëtorë
Se pastaj do të pendohi.

BUKURIJA

1.

1 : 1 Do të këndonj Bukurinë

1 : 2 E të lëvdonj Perëndinë,

1 : 3 Perëndin’ e bukurisë,

1 : 4 Q’i dha shije gjithësisë!

1 : 5 Perëndija bukuroshe!

1 : 6 Ty të falem e të lutem

1 : 7 Më vjen në gji të të futem

1 : 8 Zonja përkëdheloshe!

1 : 9 Që më je si mbretëreshë,

1 : 10 Të keqen o pëllumbeshë.

2.

2 : 1 Zot i vërtetë!

2 : 2 Ke mbledhur dritën,

2 : 3 Diellin, dritën,

2 : 4 Ndë gjithë jetë,

2 : 5 Edh’ e ke bërë

2 : 6 Gush’ e krahruar,

2 : 7 Faqez’ e ballë,

2 : 8 Dhe pulp’ e llërë,

2 : 9 Sy e qepallë,

2 : 10 Dhe këmb’ e duar!

3.

3 : 1 Në fytyrët tënde gjeta Bukurinë.

3 : 2 Si ajy që gjeti në malt Perëndinë

3 : 3 Lulezët e Majit sa janë të mira!

3 : 4 Po përpara teje m’erdhë të pështira.

3 : 5 Kur shoh faqezët’ e tua,

3 : 6 Ç’vjeft’ i mbetet trëndafilit,

3 : 7 Zëri yt shpirt më jep mua,

3 : 8 Nuk’ i le shije bilbilit.

3 : 9 Edhe yjt’ e hëna si të shëmëtuar

3 : 10 M’u duknë, kur pashë atë syn’e shkruar.

3 : 11 Purtek’ e florinjtë! shigjet’ e ergjëntë!

3 : 12 Zëmrënë m’a dogje, m’i përndave mëntë!

3 : 13 Do të vdisnja me shumë gas,

3 : 14 Të paskësha pakë shpresë,

3 : 15 Se do të thuash ti më pas,

3 : 16 Vdiq, për mua, pastë ndjesë.

4.

4 : 1 Kudo është Bukurija,

4 : 2 Në qiej, në dhë, në hënë,

4 : 3 Në diell, në shenjë, në yje,

4 : 4 Ndër lule, ndër drurë, ndër pyje,

4 : 5 Çdo vënt që të ketë zënë,

4 : 6 Atje çfaqet Perëndija,

4 : 7 Po këtu është e tërë,

4 : 8 Dhe ajo tin është bërë!

5.

5 : 1 Pashë pjeshkëtë ndër fletë,

5 : 2 Pa m’u-mejtua gjiri yt,

5 : 3 Edhe më mbenë përpjetë

5 : 4 Në zëmrët, në shpirtit, në syt!

5 : 5 Jaseminë kur e pashë,

5 : 6 Q’ish i bardhë si dëborë,

5 : 7 Pse më ndjek zemrën, i thashë,

5 : 8 E më ngjan më atë dorë?

5 : 9 Dhe në mejtim të madh rashë,

5 : 10 Më ra në det mëndja, m’u mbyt,

5 : 11 Më la vetëm e të shkretë,

5 : 12 Edhe të mjer’ e të gjorë!

6.

6 : 1 Qiriri meje ka mësuar

6 : 2 Të digjet të përvëlohet,

6 : 3 Edhe duke përvëluar,

6 : 4 Të qeshnjë e të gëzohet,

6 : 5 Të bënetë zjar e flakë,

6 : 6 Të tretët pak’ e nga pakë.

6 : 7 Ti e msove trëndafilë

6 : 8 Të çelet, të lulëzohet,

6 : 9 Të qeshnj’ e të zbukurohet,

6 : 10 T’a përvëlonjë bilbilë,

6 : 11 E f a bënjë të pëlcasë,

6 : 12 Një fjalë të mos i flasë,

6 : 13 Dhe nga kjo t’i vinjë mirë,

6 : 14 Të xbukurohet më mirë,

6 : 15 E të mos ketë mëshirë,

6 : 16 Po t’a lerë dne pa gjumë.

7.

7 : 1 Bërthama jote o hurma!

7 : 2 Më rrëfen bukur e mirë;

7 : 3 Zemr’ e buz-ëmblësë, më tha,

7 : 4 Ësht’ e fort’ e p’ amblësirë.

7 : 5 Po fjalënë s’ja besova,

7 : 6 Nuk’ ësht’ e vërtetë, thashë,

7 : 7 Tani holl e kupëtova,

7 : 8 Se me syt’ e mi e pashë.

8.

8 : 1 more shtat i florinjtë!

8 : 2 Bukurija teje buron,

8 : 3 Edhe të rrjedh nga pëqinjtë,

8 : 4 Gjithë jetën e xbukuron.

8 : 5 Më ecën me shumë shije,

8 : 6 Dhe si thellëza më vështron,

8 : 7 Edhe më hedh nje shkëndijë,

8 : 8 Dhe zemrënë m’ a përvëlon.

8 : 9 Të keqen e këmbës sate,

8 : 10 Të ju-bëfsha ati syri,

8 : 11 E leshravet si tërtërë,

8 : 12 E qepallës si gjilpërë,

8 : 13 Që në zëmërë më hyri.

8 : 14 Ç’pate, që më vrave, ç’pate?

8 : 15 Nga qepallatë jam qarë,

8 : 16 Po të vërtetën’ e gjeta,

8 : 17 Vetullat më paskan vrarë,

8 : 18 Më vrau hargu, jo shigjeta.

9.

9 : 1 Zëmra jote në krahrort tënt

9 : 2 Është hekur brënda n’ergjënt;

9 : 3 Dhe në linj’ ajy krahruar,

9 : 4 Si ndë dhë gur’ i paçmuar.

9 : 5 Dielli zënë me rezë,

9 : 6 Vera në qelqe të zezë,

9 : 7 Shpirti brënda nër qivure,

9 : 8 Zot’ i madh nër katrë mure!

10.

10 : 1 Do të shtrihem

10 : 2 Të venitem,

10 : 3 Si kandili kur s’ka vaj,

10 : 4 Balt’ e pluhur

10 : 5 Do të bëhem,

10 : 6 Të më shkelnjë këmb’ e saj;

10 : 7 E të prehem

10 : 8 Duke puthur

10 : 9 Atë këmbë pasandaj.

10 : 10 As më thua,

10 : 11 Ç’ke me mua?

10 : 12 Pse të dua paskam faj?

11.

11 : 1 Pse heq unë

11 : 2 Hidhërime,

11 : 3 A në vdekça, ti mos qaj,

11 : 4 Vdekja ime,

11 : 5 S’të prish punë,

11 : 6 Haj, e zeza jetë, haj!

11 : 7 veri! pa hiq i thua

11 : 8 Sorkadhësë qafë-gjatë:

11 : 9 Më ka thënë pyllë mua,

11 : 10 S’mblidhem dot as dit’ as natë!

11 : 11 Pyetë vallë përse,

11 : 12 Pastaj jak’ e më rrëfe.

11 : 13 Bukuroshe! sy-mëshqerë!

11 : 14 Shikomë një herë mua,

11 : 15 Trëndafil’ i kuq me erë!

11 : 16 E di vallë sa të dua?

11 : 17 E mora vdekjen në sy,

11 : 18 Do të vdes, të vdes për ty.

12.

12 : 1 ...Mos i hap leshratë n’erë

12 : 2 Të m’arratiç mëndjen t’ime,

12 : 3 Mos më shiko dhe një herë,

12 : 4 Se m’u bë zëmra thërrime.

12 : 5 Si thëllëx’ e bukur mos shko

12 : 6 Mos vështro si pëllumbeshë,

12 : 7 Shpirtinë mos m’a përvëlo,

12 : 8 Mos u tunt si mbretëreshë.

12 : 9 Me qepallatë si shtijë

12 : 10 Mos më vra mos më plagos,

12 : 11 Me vështrim po si shkëndijë

12 : 12 Mos më vdis e mos më sos.

13.

13 : 1 E pashë dije tek shkonte,

13 : 2 Soje ndritte gjithë jeta,

13 : 3 Pa hoth syt’ e më shikonte,

13 : 4 Duke kthyer si shigjeta!

13 : 5 Posa pashë Bukurinë,

13 : 6 Zemrën’ e varfrë m’a piku,

13 : 7 Ndjeva në të dashurinë,

13 : 8 Që më erdh, dhe më s’më iku,

13 : 9 Pse s’ka fjalë të dëftenjë

13 : 10 Dashurin’ e Bukurinë,

13 : 11 Nuk’ e them dot atë ndjenjë,

13 : 12 Nuk’ e them dot Perëndinë!

13 : 13 Mos u mundo kot,

13 : 14 Nukë thuhet dot.

14.

14 : 1 M’iku me vrap djalërija

14 : 2 E më la mbi dhe të shkretë,

14 : 3 Më erdh shtriga pleqërija

14 : 4 Fshehtazi, si qen’ i qetë.

14 : 5 popo! ç’më gjet, o shokë,

14 : 6 Do të qanj me thes më kokë,

14 : 7 ditët e djalërisë.

14 : 8 Që kishit shumë gëzime

14 : 9 Ratë në det t’arratisë,

14 : 10 Më latë në hidhërime!

14 : 11 Tani jetënë ç’e dua,

14 : 12 Më s’ësht’ e shkreta për mua.

14 : 13 Ti o bukuroshja ime!

14 : 14 Të ritë m’a paç për jetë,

14 : 15 Kurrë mos pafsh hidhërime!

14 : 16 Të dashtë Zot’ i vërtetë!

14 : 17 Syri yt mos u-venittë.

15.

15 : 1 Vera vate, shkoj,

15 : 2 Bilbili pushoj,

15 : 3 Lulet u-thanë!

15 : 4 Dimëri u-qas,

15 : 5 Dëborë vjen pas,

15 : 6 Fletëtë rënë.

15 : 7 Gjësendi më s’mbet

15 : 8 Thua për mi dhet,

15 : 9 Shpestë pushuan!

15 : 10 Zëmra ime zjen,

15 : 11 E ty më s’të gjen

15 : 12 Pa heq e vuan.

16.

16 : 1 Erdh e na gjet

16 : 2 Vera mi dhet,

16 : 3 Dhe këtë herë

16 : 4 Për shumë vjet

16 : 5 E me shëndet,

16 : 6 Na gieç, o verë!

16 : 7 Sa më pëlqen,

16 : 8 E ç’më dëfren

16 : 9 Luleja mua!

16 : 10 Ç’mirë më vjen

16 : 11 Se shembëllën

16 : 12 Faqet e tua.

16 : 13 Del të të shoh,

16 : 14 Oh! oh! oh! oh!

16 : 15 sy mëshqerë

16 : 16 Dua t’a ngroh,

16 : 17 Se po m’u ftoh

16 : 18 Zemr’ e mjerë.

16 : 19 Syri m’u vesh,

16 : 20 Po del në shesh,

16 : 21 Malli m’u shtua,

16 : 22 Shih, mos më lesh!

16 : 23 Popo! kur qesh,

16 : 24 Ah, sa të dua!

VAREFERIJA

1.

1 : 1 Ju të pasur, kur rrini

1 : 2 Rreth zjarit me gëzime

1 : 3 Qeshni, hani e pini,

1 : 4 Xbaviti me dëfrime.

1 : 5 Këceni e këndoni,

1 : 6 Dhe çeli e gëzohi,

1 : 7 Bëni gaxhi e loni

1 : 8 Edhe prëhi e ngrohi.

1 : 9 Ju vjen së largu afshi,

1 : 10 Ndë sallonet të gjerë,

1 : 11 Shtruarë pej mëndafshi

1 : 12 Mbushur me gjë të vlerë.

1 : 13 Nga ari, nga ergjëndi,

1 : 14 Nga floriri, nga drita

1 : 15 Llapëtin gjithë vëndi,

1 : 16 Tfaqet natënë dita.

1 : 17 Zonjat bukuroshe

1 : 18 Veshur, rrobat’ e arta,

1 : 19 Vashatë vogëloshe,

1 : 20 Të bardha posi karta.

1 : 21 Djemthit e përkëdhelur

1 : 22 Të lartë e të ndruar

1 : 23 Me zëmërë të çelur,

1 : 24 Me buzë të gëzuar.

1 : 25 Vinë rreth e kërcejnë,

1 : 26 Dhe qeshin e këndojnë,

1 : 27 Lozinë e dëfrejnë,

1 : 28 Kohën me gaz e shkojnë.

1 : 29 Dhe juve duke parë

1 : 30 Me sy fatbardhësinë,

1 : 31 S’ju vjen fare të qarë

1 : 32 Vallë për varfërinë?

1 : 33 E dini, q’është jashtë

1 : 34 Një plak’ e dobëtuar:

1 : 35 E përgynjyr, e lashtë,

1 : 36 E mjer’ ë dëshëruar,

1 : 37 E fishkur’ edh’ e thatë,

1 : 38 E thinjur e kërcure,

1 : 39 E urët dit’ e natë,

1 : 40 Dergjetë nër qivure!

1 : 41 Një plak’ q’i vdiq fëmija,

1 : 42 Edhe mbet e helmuar,

1 : 43 Se ju shkretua shtëpija,

1 : 44 Mbet si kandil’ i shuar!

1 : 45 Një foshnj’ e varfëruar,

1 : 46 Pa mëmëz’ e pa atë,

1 : 47 E gjor’ e dobëtuar!

1 : 48 E ligur e e thatë!

1 : 49 Gjithë këta të mjerë

1 : 50 Në të këqija rrojnë,

1 : 51 Vin’ e lipin më derë,

1 : 52 Një kafshitë kërkojnë!

1 : 53 E kur vjen të kërkonjë,

1 : 54 Brengën s’munt t’a rrëfenjë,

1 : 55 E rreh të na dëfrenjë!

1 : 56 Sa ’shtë turp për njerinë,

1 : 57 Ku shkojm’ e s’kthejmë synë!

1 : 58 S’dëgjojmë Perëndinë?

1 : 59 S’është vëllathi ynë?

1 : 60 Oh! epni, ju që kini,

1 : 61 Kush i ndih varfërisë,

1 : 62 Ay q’ep, po e dini,

1 : 63 Q’i huan Perëndisë.

1 : 64 T’apim, se vjen një ditë

1 : 65 Q’e lemë këtë jetë,

1 : 66 Dhe gjen’ e begatitë,

1 : 67 Vemi në të vërtetë,

1 : 68 Përpara Perëndisë,

1 : 69 Që do të na gjykonjë,

1 : 70 Urat’ e varfërisë

1 : 71 Arrin të na shpëtonjë.

1 : 72 Ajo or’ e borinjtë,

1 : 73 Që ligjëron e bije,

1 : 74 Rreth t’i mplaknjë të rinjtë,

1 : 75 Buzë varrit na shpije!

1 : 76 Epni t’u falnjë Zoti

1 : 77 Juve gjithë të mirat,

1 : 78 E të mos muntnjë moti

1 : 79 T’ju sjellë të pahirat.

1 : 80 Mba unazat në dorë

1 : 81 Pa një farë nevoje!

1 : 82 Zonjë! shumë të gjorë

1 : 83 Vdesën për bukë ngojë!

1 : 84 Ep t’apë Perëndija

1 : 85 Të gjitha mirësitë,

1 : 86 Të të kenë fëmija

1 : 87 Shëndet e jet’ e ditë.

1 : 88 Zot i madh, i vërtetë!

1 : 89 E gjithë ju të Mirët!

1 : 90 Mos e lini për jetë

1 : 91 Njerinë n’errësirët.

2.

2 : 1 Sa jemi Shqipëtarë,

2 : 2 Kemi gjithë një besë,

2 : 3 Jemi gjithë një farë,

2 : 4 Dhe rrojmë me një shpresë,

2 : 5 S’jemi kurrë të ndarë.

2 : 6 Bes’ është Perëndija

2 : 7 Për gjithë Shqipëtarët.

2 : 8 Edhe vëllazërija,

2 : 9 Urtësija, të mbarët,

2 : 10 Fë është njerëzija.

2 : 11 Më çdo vënt që të jemi,

2 : 12 Mëmëdhen’ e kujtojmë,

2 : 13 Edhe kudo të vemi,

2 : 14 Kombinë s’e harrojmë,

2 : 15 Vëllazërin’ e kemi.

2 : 16 Si do që të na ndajnë,

2 : 17 Ne jemi të bashkuar,

2 : 18 S’mundinë të na çajnë,

2 : 19 Zoti na ka uruar,

2 : 20 Pa në kurt dot s’na mbajnë.

2 : 21 Në ka pasur në jetë,

2 : 22 Trima shumë të ndjerë,

2 : 23 E burra të vërtetë,

2 : 24 Kombi yn’ i ka nxjerë,

2 : 25 At’ e di Zoti vetë.